



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Programit Komunal trevjeçar për banim 2022-2025 i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.360/01-52753 i datës 28.09.2022, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E  
FAMILJEVE

Neni 1  
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve, të cilat kanë aplikuar sipas Konkursit Publik 1Nr.360/01- 59084 të datës 02.11.2022 për të përfituar nga Programi i veçantë i banimit, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në përbërje si vijon:

1. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesues
2. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor - juridik, anëtar
3. Lorik Berbatovci, Qendra për Punë Sociale, anëtar
4. Fjolla Ibrahim, Qendra për punë Sociale, anëtare
5. Ismet Jashanica, Drejtorati për Inspektorat, anëtar

Neni 2  
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni bënë vlerësimin me pikë sipas kriterëve të përcaktuara në Shtojcën Nr.1 të Udhëzimit Administrativ 21/2010 të Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor "Për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit".

Komisioni gjatë gjithë punës së tij do të ketë për bazë respektimin e dispozitave të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164, Programit Komunal trevjeçar për banim 2022-2025 dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që rregullojnë fushën e banimit.

Komisioni në teren bënë vlerësimin e gjendjes së banimit të familjeve si dhe verifikimin e të dhënave të kërkuarve në teren brenda (30) tridhjetë ditëve.

Komisioni mban procesverbal për punën e tij .

Komisioni është i obliguar që gjatë procesit të pranimit, vlerësimit të dokumentacionit dhe kërkesave, të mbrojë të dhënat personale të palëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Komisioni pas përfundimit të detyrave të cekura përgadit Raport me shkrim për Kryetarin e Komunës duke i bashkëngjitur listën përfundimtare e cila do të publikohet brenda afatit ligjor.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

INr. 020/01-64497  
Lipjan, më 05-12- 2022

KRYETARI KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 duke u bazuar në pikën IV të Vendimit për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi" Nr.15-020/04-52742 të datës 28.09.2022, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM  
PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENZIMIT TË ANËTARIT TË KOMISIONIT KOMUNAL TË  
AKSIONARËVE I DELEGUAR NGA KRYETARI I KOMUNËS NË NDËRMARRJEN  
PUBLIKE LOKALE "PASTRIMI"

I.Me këtë Vendim përcaktohet kompensimi i anëtarit të Komisionit Komunal të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" **Valon Pacolli** i caktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve 15Nr.463/06-21274 të datës 26.04.2022, në numrin rendor 1 në numrin rendor 1 dhe i deleguar nga Kryetari i Komunës.

II.Anëtari i komisionit komunal të aksionarëve i cekur më lartë do të kompenzohet për çdo muaj sipas pagës së përcaktuar minimale të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" ku të njëjtit shërbejnë.

III. Mjetet financiare për kompensimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve do të merren nga Ndërmarrja Publike Lokale "Pastrimi" ku edhe shërbejnë.

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Ndërmarrja Publike Lokale "Pastrimi"

V.Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

1Nr. 400/01-64593  
Lipjan, 05.12.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmetij





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD.HOC PËR EVIDENTIMIN-REGJISTRIMIN E ASETEVE E TË VJETRA TË KOMUNËS JASHTË PËRDORIMIT

I. Me këtë Vendim formohet Komisioni i përkohshëm ad.hoc për evidentimin dhe regjistrimin e aseteve të vjetra jashtë përdorimit, të cilat ishin në përdorim paraprak nga ana e zyrtarëve në objektin e vjetër të Komunës apo në zyret e tjera të Administratës Komunale të cilët zyrtarë/e tani më janë vendosur në objektin e ri të Komunës.

II. Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Burim Gashi, Kryesues
2. Gafurr Hetemi, anëtar
3. Ramiz Gashi, anëtar

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë evidentimin dhe regjistrimin e aseteve të vjetra jashtë përdorimit, të cilat ishin në përdorim paraprak nga ana e zyrtarëve në objektin e vjetër të Komunës apo në zyret e tjera të Administratës Komunale të cilët zyrtarë/e tani më janë vendosur në objektin e ri të Komunës.

Komisioni regjistrimin e aseteve të vjetra do ta hartoj në formë të listës për secilin zyrtar dhe përkitazi me detyrat e cekura do të raportoj me shkrim Kryetarit të Komunës më së largu me datë 26.12.2022.

IV. Komisioni ka mandat të përkohshëm dhe me përfundimin e detyrave të cekura pushon edhe mandati i tij.

V. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

VI. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

1Nr. 020/01-64850  
Lipjan, më 07-12-2022



KRYETARI I KOMUNËS

Amri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

**VENDIM**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR**  
**SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,140.00€**, (shtatë mijë e njëqind e katërdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-63956 të datës 01.12.2022, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 34 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin nëntor të vitit 2022 me nga 210 euro për secilin rast  $34 \times 210 = 7,140.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI – dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

**Neni 3**

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-63956  
Lipjan, më 07.12.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 duke u bazuar edhe në Shkresën e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursave për student Nr.01-670/01-62601, Kryetari i Komunes nxjerr:

#### VENDIM

### PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT 1Nr. 400/01-42081 TË DATËS 09.08.2022 PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSIVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË BURSË PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK-SHKOLLOR 2022/2023

#### Neni 1

I Me këtë Vendim plotësohet Vendimi 1Nr. 400/01-42081 i datës 09.08.2022 për caktimin e numrit të bursave dhe shumës financiare për një bursë për studentë për vitin akademik-shkollor 2022/2023, përkatësisht shtohen edhe 15 bursa (pesëmbëdhjetë) nga 160 (njëqind e gjashtë dhjetë) sa ishin në Vendimin paraprak, ashtu që numri përgjithshëm i bursave do të jetë gjithsej 175 ( njëqind e shtatëdhjetë e pesë) konform edhe Shkresës së Komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursave për student Nr.01-670/01-62601 të datës 09.08.2022 aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe shuma financiare për një bursë do të jetë 500 € (pesëqind) euro .

#### Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

#### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë .

1Nr. 400/01-42081/2  
Lipjan, më 08.12.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 të Ligjit Nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

I. Me këtë Vendim formohet Komisioni i ankesave për shqyrtimin e ankesave, kundër Aktvendimeve të Inspektorëve përkatës komunal në përbërje si vijon:

II. Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Rafete Retkoceri, Kryesuese
2. Islam Kaleshi, anëtar
3. Shkëlqesa Miftari, anëtare

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi që të shqyrtoj ankesat e parashtruara kundër Aktvendimeve të Inspektorëve përkatës komunal, të cilat Aktvendime kanë për bazë juridike dispozitat e Ligjit Nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Komisioni i ankesave shqyrton ankesën brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit.

Mandati i Komisionit është (3) tre vjeçar

IV. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

I.Nr. 020/04-65897

Lipjan, më 13.12.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, konform dispozitave të Marrëveshjes së Partneritetit ndërmjet Projektit për Komuna Transparente, efektive dhe llogaridhënëse –DAI GLOBAL LLC dhe Komunës së Lipjanit dhe INTERADRIA L.L.C. INr-400-58553 të datës 23.09.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM  
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej 7,633.00 € (shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tri euro) për zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Partneritetit ndërmjet Projektit për Komuna Transparente, efektive dhe llogaridhënëse –DAI GLOBAL LLC dhe Komunës së Lipjanit dhe INTERADRIA L.L.C. INr-400-58553 të datës 23.09.2021.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime të planifikuara për Drejtoratin për Administratë në xhirollogarinë bankare :

**Banka: TEB**

**Emri: INTERADRIA L.L.C**

Numri i llogarisë bankare 1181002249000120

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Administratë.

INr. 01-400/01-67694  
Lipjan, më 27.12.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E PUNËTORIT MË TË MIRË PËR  
VITIN 2022

**Neni 1**  
**Përbërja**

Formohet Komisioni për përzgjedhjen e punëtorin më të mirë të administratës së Komunës së Lipjanit për vitin 2022, në këtë përbërje:

1. Elmaze Behluli, Drejtoreshë për Administratë, Kryesuese
2. Anila Reçica-Llugiqi, Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
3. Vlora Krasniqi, nga Sindikata e administratës së Komunës, anëtare

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësit**

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e propozimeve nga të gjitha Drejtoratet e Komunës dhe Zyra e Kryetarit të Komunës dhe nga propozimet e marra të përzgjedhë punëtorin më të mirë të administratës së Komunës së Lipjanit për vitin 2022.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe më të njëjtin do të njoftohet, Kryesuesesja dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 112/07-67917  
Lipjan, më 28.12.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imr. Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 , Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Shoqatës së të drejtave të pacientëve nr 01-660/03-35326 i datës 06.07.2022 , Rekomandimit të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit të pacientëve të cilët kanë aplikuar sipas Ftesës publike për aplikim të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Nr. 3-500/01-49831 të datës 16.09.2022, me qëllim të themelimit të Këshillit të Pacientëve , Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

#### VENDIM

#### PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT TË PACIENTËVE NË KOMUNËN E LIPJANIT

I.Me këtë Vendim themelohet Këshilli i Pacientëve në Komunën e Lipjanit duke u bazuar në Rekomandimin përfundimtar të Komisionit përzgjedhës, në përbërje si vijon:

1. Alush Bikliqi, Kryesues
2. Ariana Bytyqi –Fazliu
3. Fehmi Rexhepi
4. Agim Murtezi
5. Fitore Krasniqi

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Pacientëve janë të përcaktuara me Rregulloren për themelimin dhe funksionimin e Këshillave të pacientëve dhe Kodin e Etikës .

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset DSHPS dhe Këshilli i Pacientëve.

IV.Mandati I anëtarëve të Këshillit të pacientëve është 3 (tre) vjeçar.

V.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ,Kryesuesi dhe anetarët e Këshillit të pacientëve.

1Nr. 020/04-68110  
Lipjan, më 29.12.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës, Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1  
Përbërja

Formohet Komisioni për testimin e shpenzimeve të veturave zyrtare në këtë përbërje:

1. Behar Mjeku , Kryesues,
- 2.Naman Limani, anëtar,
3. Shefki Sadiku, anëtar
- 4.Bujar Curri, anëtar,
5. Rrahman Olluri,

Neni 2  
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është vërtetimi - testimi i saktë i shpenzimeve të të gjitha veturave zyrtare të Komunës.

Pas vërtetimit - testimit të saktë të shpenzimeve të të gjitha veturave zyrtare të Komunës, Komisioni duhet të përgadisë raport me shkrim të cilin duhet tia dorëzojë Kryetarit të Komunës dhe një kopje për Drejtoreshën e Drejtoratit për Administratë .

Neni 3  
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtori i Drejtoratit për Administratë, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

INr. 020/04-68392  
Lipjan, më 30.12.2022

KRYETARI I KOMUNËS  
për Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, në zbatim të nenit 12 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike Kryetari i Komunës merr

### VENDIM

- Formohet grupi punues për identifikimin, vlerësimin dhe përcaktimin e veprimeve ndaj rrezikut në procesin e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve nga të drejtoratet përkatëse të Komunës së Lipjanit, në përbërje prej:
  - Shehadije Ibrahim, Koordianore e grupit punues,
  - Armend Duriqi, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
  - Burim Gashi, Drejtorati për Administratë
  - Visar Kozhani, ZKF
  - Islam Kaleshi, Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore
  - Kushtrim Salihu, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm, Mbrojtje dhe Shpëtim
  - Bekim Arifi, Drejtorati për Prokurim
  - Floranda Zeqiri, Drejtorati për Arsim
  - Shqipe Rexhepi, Drejtorati për Inspeksion
  - Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim
  - Merita Zeqiri, Drejtorati për Infrastrukturë
  - Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
  - Sadete Maholli, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari
  - Alban Bytyqi, QKMF
  - Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport
  - Behar Krasniqi, Zyra e Avokatit publik komunal
  - Gafur Hetemi, Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektori pronësor-juridik
  - Halit Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Sektori për Tatim në Pronë
  - Fauz Xhemajli, Sektori i gjendjes Civile
- Obligohen të gjitha Drejtoratet përkatëse të Komunës që në procesin e planifikimit për vitin 2023 të parashohin riksun dhe menaxhimin e tij;
- Grupi punues obligohet të hartoj Listën dhe Planin e menaxhimit të rreziqeve në Komunën e Lipjanit.
- Afati kohor për identifikimin e Listës së rreziqeve është data 15 dhjetor 2022.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Koordiantoria dhe anëtarët e tjerë të grupit punues.

1Nr. 016/01-63928  
Lipjan, më 30.11 2022

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

